



**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°27/2022

Hagë, 14/07/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në përputhje me urdhrin e Gjykatës së Apelit të lëshuar më 1 korrik, z. Gucati dhe z. Haradinaj ridorëzuan njoftimin për apel kundër aktgjykimit.

Më 12 korrik 2022, në çështjen gjyqësore z. Thaçi dhe të bashkakuzuarit, Paneli i Apelit rrëzoi apelin e z. Thaçi kundër vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake mbi miratimin e kërkesës së ZPS-së për ndryshimin e listës së saj të provave materiale që do t'i përdorë gjatë gjykimit.

Në apelin e tij, z. Thaçi, ndër të tjera, argumentoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kishte marrë sa duhet parasysh se provat që i shtohen listës së provave materiale të ZPS-së, në këtë fazë kaq të vonët, do të ndikojnë negativisht në aftësinë e Mbrojtjes për t'u përgatitur për gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Z. Thaçi parashtroi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk kishte marrë parasysh se dosjet e dëshmitarëve që tanimë janë analizuar do të duhej të analizoheshin përsëri, sepse materiali shtesë që shtoi ZPS-ja, përfshin dëshmitarë për të cilët tashmë janë nxjerrë deklarata dhe prova materiale shoqëruese.

Paneli i Gjykatës së Apelit konstatoi se Gjykatësi i Procedurës Paraprake kishte marrë parasysh sa duhet argumentet e z. Thaçi dhe përcaktoi se materiali shtesë ka të bëjë me dëshmitarë të cilët tashmë janë të njohur për Mbrojtjen. Rrjedhimisht, ndryshimi i listës së provave materiale jo domosdoshmërisht ndikoi ose vonoi përgatitjet për gjykim, sepse ndër të tjera edhe Mbrojtja sapo kishte filluar hetimet e veta.

Paneli vuri në dukje se materialet shtesë iu dhanë Mbrojtjes më 31 janar 2022, në bazë të urdhrin të Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe se Gjykatësi i Procedurës Paraprake paralajmëroi ZPS-në se duke pasur parasysh mbarimin e këtij afati,

1





**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°27/2022

Hagë, 14/07/2022

kërkesat e tjera për ndryshime të listës së provave materiale do t'u nënshtroheshin shqyrtimeve më të hollësishme.

Në po këtë çështje gjyqësore, Gjykatësi i Procedurës Paraprake dje mbajti konferencën mbi ecurinë e çështjes, gjatë së cilës u diskutuan procesi i nxjerrjes së materialit, si dhe aspekte të tjera organizative në lidhje me ecurinë e procesit. Në fund të seancës, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, ndër të tjera, urdhëroi ZPS-në që të dorëzojë listën e dëshmitarëve deri më 2 shtator 2022, me përditësime për mënyrën e marrjes në pyetje dhe kohën e paraqitjes për secilin dëshmitar që ata synojnë të thërrasin.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu propozoi 8 shtator 2022 si datë për konferencën e ardhshme mbi ecurinë e çështjes.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje.

